



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 226/3.prot

Gramsh, më 25.05/2024

VENDIM

Nr. 43 Datë 31.05.2024

Për ndryshimin e orarit të linjës Gribë-Gramsh dhe Kukur-Gramsh.

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 31/05/2024 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e "Taksave dhe Tarifave Vendore", Sektori i të Ardhurave nga Biznesi dhe Transporti, për ndryshimin e orarit të linjës Gribë-Gramsh dhe linjës Kukur-Gramsh, në mbështetje të ligjit nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, Vkm nr. 325, datë 19/03/2008 mbi "rregullat për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve zyrtare të caktuar për këta operatorë", udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika

2

Vendos:

- I. Të miratojë ndryshimin e orarit Gribë-Gramsh dhe Kukur Gramsh:
Orari do të jetë si më poshtë:
Nisja nga Griba në orën 07:00 dhe kthimi në orën 13:00.
Nisja nga Kukuri në orën 07:00 dhe kthimi në orën 13:30.
- II. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria "Taksave dhe Tarifave Vendore", Sektori i të Ardhurave nga Biznesi dhe Transporti, e ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Enis ZANI





[Handwritten signature]



2126/1
13.06.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 062/prot.

Elbasan, më 13.6.2024

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, përpara se të shprehemi në lidhje me ligjshmërinë e aktit tuaj Nr. 43 datë 31.05.2024 "Për ndryshimin e orarit të linjës Gribë-Gramsh dhe Kukur-Gramsh", referuar shkresës me Nr. 2126/1prot, datë 21.05.2024 "Relacion për ndryshimin e orarit të linjës Gribë-Gramsh dhe Kukur-Gramsh" të Bashkisë Gramsh (fjalisë së fundit të saj), bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e aktit tuaj, kërkojmë të na vini në dispozicion një kopje të:

- 1 - Kërkesës së banorëve (me nënshkrimet përkatëse të tyre) të fshatit Gribë, Njësia Administrative Kukur,
 - 2 - Kërkesës së banorëve (me nënshkrimet përkatëse të tyre) të fshatit Kalaj, Njësia Administrative Kukur,
 - 3 - Kërkesës me Nr. 1968prot, datë 13.05.2024 të bërë nga subjekti Festim Kokla i linjës Gribë-Gramsh dhe
 - 4 - Kërkesës me Nr. 2126prot, datë 20.05.2024 të bërë nga subjekti Ariol Hënkoja i linjës Kukur-Gramsh pasi ato mungojnë (ato nuk i janë bashkëlidhur kësaj shkrese).
- Deri në dërgimin e këtyre të dhënave, akti juaj mbetet i pa konfirmuar.

PREFEKTI

NË MUNGESË DHE ME VARDHËR

NËNPREFEKTI

Albert CECI

